VENDIM
Nr. 402, datë 13.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 914, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullave të prokurimit publik, që i bashkëlidhet vendimit nr. 914, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, në nenin 26, të seksionit II, të kreut III, "Dokumentet e tenderit", bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 10, emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve" zëvendësohet me "Autoriteti Rrugor Shqiptar".

b) Pas paragrafit të parë, të pikës 10, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nënkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkaqe të përligjura, si:

i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si KUZ, OSHEE etj;

ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike;

iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona;

iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim;

v) rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit.

Në çdo rast, një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve pjesë e kontratës, deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama